



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 212/1 prot.

Tiranë më 13.2.2019

Lënda: Mendim mbi Projektstrategjinë “Për edukimin ligjor të publikut”

KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE,
ADMNISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

KUVENDI

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.497 Prot., datë 06.02.2019, me anë të cilës kërkohet mendim mbi Projektstrategjinë “Për edukimin ligjor të publikut”, Zyra e Komisionerit e vlerëson, se në tërësi është hartuar konform parashikimeve ligjore që përfshijnë fushat e përgjegjësisë së institucionit tonë.

Zyra e Komisionerit si pjesë e grupit të punës, ka dhënë kontributin e saj për hartimin e Projektstrategjisë “Për edukimin ligjor të publikut”.

Ndërkohë, duke marrë parasysh përditësimin e shifrave dhe statistikave në lidhje me veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Mbrojtjes së të Dhënave Personale për vitin 2018, sugjerojmë sa më poshtë vijon:

Në faqen 49, të Projektstrategjisë, ndryshohet paragrafi mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Ndërsa në faqen 50, shtohet një fjali mbi zbatimin e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Sugjerimet përkatëse i dërgojmë bashkëlidhur kësaj shkrese, si dhe në rrugë elektronike në adresën cituar në shkresën tuaj.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



Në faqen 49, të Projekt/strategjisë “Për edukimin ligjor të publikut”, paragrafi në lidhje me veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, i referohet raportit me të dhënat për vitin 2017. Për këtë arsye, duke marrë parasysh përditësimin e shifrave dhe statistikave për vitin 2018, sugjerojmë që të zëvendësohet si më poshtë:

Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Mbrojtjen e të Dhënave Personale është tepër i rëndësishëm për të garantuar zbatimin korrekt të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Duke iu referuar raportit vjetor nga ky institucion, gjatë vitit 2018¹, rezulton se ka përmirësime të ndjeshme në këtë drejtim. Janë kryer 283 inspektime nga Zyra e Komisionerit lidhur me respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga monitorimi i autoriteteve publike për vitin 2018, ka rezultuar se institucionet të cilat kanë një program të plotë dhe të përditësuar transparence janë institucionet e pavarura. Zyra e Komisionerit vlerëson se, niveli i transparencës për institucionet e pushtetit qendror shënon përmirësime në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me pushtetin vendor, Zyra e Komisionerit vlerëson se niveli i transparencës së bashkive shënon përmirësime. Zyra e Komisionerit me anë të Urdhrit nr.211, datë 20.09.2018, ka miratuar Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Janë trajtuar 820 ankesa që pretendonin cenimin e të drejtës së informimit. Zyra e Komisionerit ka përfunduar implementimin e instrumentit të vetëvlerësimit të transparencës në institucionin e Presidentit, Kuvendit, Kryeministrit si dhe në të gjitha ministritë dhe institucionet e pavarura. Në këtë kuadër u zhvilluan trajnime për të gjithë koordinatorët e të drejtës për informim dhe u hartua raporti përfundimtar dhe rekomandimet për secilin institucion.

E drejta për informim ka qenë pjesë e programit të trajnimit të detyruar për nëpunësit civil në periudhë prove, në të cilat kanë marrë pjesë 370 nëpunës civil. Janë zhvilluar veprimtari për ndërgjegjësimin e studentëve, stafit akademik, sistemit gjyqësor, organet e rendit, medias, si dhe për publikun e gjerë.

Tepër të rëndësishme janë gjetjet e veprimtarisë monitoruese të Komisionerit, nga e cila ka rezultuar se 219 Autoritete Publike kanë miratuar dhe bërë publik programin e transparencës; 331 autoritete publike kanë caktuar Koordinator për të drejtën e informimit; 178 Autoritete Publike kanë krijuar dhe publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve². Për të bërë realitet të drejtën e qytetarëve për informim e edukim, duhet avancuar me shpejtësi për miratimin e programeve të transparencës nga të gjitha institucionet e detyruara, sipas ligjit, caktimin e koordinatorëve për të drejtën e informimit, krijimin dhe publikimin prej tyre të regjistrave të kërkesave dhe përgjigjeve. Në mënyrë të veçantë ka nevojë që subjektet e parashikuara në ligj të përmirësojnë pasqyrimin e informacionit që ofrojnë në faqet e tyre zyrtare në internet, ta pasurojnë dhe azhurnojnë atë në vazhdimësi, veçanërisht në lidhje me situatën e legjislacionit të fushës ku vepron subjekti përkatës.

¹ http://www.idp.al/wp-content/uploads/2019/02/Raporti_Vjetor_2018_KDIMDP.pdf

² Po aty fq.7

Në faqen 50, të Projekt/strategjisë "Për edukimin ligjor të publikut", shtohet si problematikë e konstatuar gjatë vitit 2018, paragrafi:

"Megjithëse ligji nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ka mbi 3 vjet që ka hyrë në fuqi, konstatojmë se ai nuk po zbatohet në nivelin e kërkuar nga organet publike, si dhe nuk po shërben si një mjet efektiv për qytetarët".